

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 16.07.2022

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim

Drejtuar: **Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë**
Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr.3, Tiranë

Për dijëni: **Znj. Delina Ibrahimaj**
Ministre e Financave dhe Ekonomisë

TIRANË

Të nderuar,

Në emër të Institucionit Jofitimprurës ABSL Albania (The Association of Business Service Leaders) e cila operon prej vitit 2018 në mbrojtje të interesave të biznesit, gjykojmë si të nevojshme përcjelljen dhe adresimin e disa problematikave që mund të lindin si pasojë e amendimeve të Ligjit “Për Tatimin mbi të ardhurat” i cili pritet të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2023.

Nëpërmjet kësaj shkrese Ju sjellim në vëmëndje disa nga pikat ku gjykojmë se nisur nga problematikat dhe nevojat e hasura nga biznesi privat, mund të afektojnë efincencën e vet ligjit si akt rregullator për mbarëvajtjen e “doing business”.

Vijojmë duke ju parashtruar disa nga referencat ku mendojmë se mund të ndikojmë për lehtësimin e klimës së sipërmarrjes private, sipas argumentave që vijojnë si më poshtë:

1. Në riformulimin e ligjit aktual “Për Tatimin mbi të ardhurat”, neni 3, shtimit të një dispozite specifike, ku ligji me ndryshimin e parashikuar shtrin efektet për detyrim të dyfishtë mbi të ardhurat nga veprimtaria e individëve tregtarë dhe atyre të vetpunësuar.

Fitimi neto pas çdo zbritje që do t'i bëhet, do të taksohet, siç taksohet çdo i punësuar. Norma e tatimit për këtë kategori do të jetë 0% për të ardhurat deri në 40,000 lekë, 13% nëse të ardhurat mujore janë deri në 150,000 lekë dhe 23% për shtesën e tyre”.

Për këtë arsye sugjerojmë shmangien e masës së taksimit në kushtet që bëhet fjalë për dy kategori të ndryshme, me detyrime përkatëse sipas fushave.

2. Regjimi i veçantë për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar. Ref. neni 14 i shtuar. Ky formulim, përcaktimi i shumës dhe heqja dorë nga mbajtja e regjistrimeve kontabel, rezulton të bjerë ndesh me procesin e fiskalizimit dhe informatizimit të sistemit tatimor si dhe shpenzimet që bizneset kanë kryer për këtë qëllim.

3. Gjithashtu referuar sipas ProjektLigjit, nëse një individ është i vetpunësuar, por i ka të ardhurat e tij nga pak klientë, ato do të konsiderohen si të ardhura nga punësimi.

Në interpretim të nenit 12, pika e) e Projektligjit sugjerojmë si të nevojshëm rishikimin e dy pikave të saj, si më poshtë vijon:

- Në pikën (i) të shtohet gjithashtu përcaktimi “në Republikën e Shqipërisë”.
- Ndryshimin e pikës (iii) pasi ndjekja e udhëzimeve të klientit është praktikë e nevojshme e bizneseve dhe përcaktohet sipas raportit tregtar që palët ndjekin me marrëveshje.

4. Anketim për profesionistët e lirë. Sipas analizave statistikore të kryera nga strukturat përgjegjëse të ABSL Albania, pjesë e ABSL International me shtrirje në 13 shtete, u arrit në përfundimin si më poshtë vijon:

Ky anketim me pjesmarrje prej 223 profesionistëve të lirë në shkallë vendi, të kategorive të ndryshme, 47% meshkuj dhe 53 % femra, rezultoi se shkalla e informimit mes grupeve të interesit që preken direkt nga ky ndryshim është :


- 76% e tyre janë të informuar mbi këtë projektligj dhe 24% e tyre nuk kanë njohuri për këtë ndryshim.



Sa i takon shkallës së informimit midis kategorive të ndryshme, vihet re se profesionistë të fushave të tilla si Jurist, HR, Operatore ose ato që ofrojnë shërbim konsulence janë më të informuarit rreth ndryshimeve më të fundit ligjore që priten të ndodhin. Ndërkohë shkallën më të ulët të informimit e kanë noterët dhe tregtarët.

Vihet re se përgjigjet e kategorisë së profesionisteve të lirë janë mospërkrahëse të këtyre ndryshimeve për arsye të çënimit të barazisë dhe ndikimit negativ tek ulja e informalitetit.

Përsa i përket ndikimit që do ketë ky projektligj në ecurinë e biznesit, vihet re se 87% e të anketuarve janë kundër këtyre ndryshimeve, 6% e të anketuarve e mbështesin këtë Projektligj dhe 7% e të anketuarve janë neutral përsa i përket efekteve që mendojnë të ketë.



5. Analizë krahasimore. Sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT, totali i shpenzimeve për bizneset e të vetëpunësuarve para Projektligj:

- Shpenzimet në lidhje me tarifat/taksat bashkiake nuk kanë pësuar rritje;
 - Shpenzime në lidhje me sigurimet shoqërore kanë pësuar rritje si efekt i rritjes së pagës minimale nga 30,000 lekë në 32,000 lekë, pagë e cila deklarohet gjerësisht nga personat e vetëpunësuar.
 - Shpenzime të shtuara si pjesë e paketës së fiskalizimit arrijnë vlerën e 10,000 lekëve në vit.
- Në rast të miratimit të këtyre ndryshimeve në ligj pasojat do të ishin:
- Për të vetëpunësuarit që deklarojnë të ardhura afërsisht 2 milion lekë, sipas draftit do të njihen 30% e të ardhurave si shpenzime dhe për pjesën tjetër do të taten 15 % duke shtuar shpenzimet e tyre vjetore me 210,000 lekë.
 - Për të vetëpunësuarit që deklarojnë të ardhura afërsisht në shumën 5 milion lekë, sipas draftit me ndryshime do t'u njihen 30% e të ardhurave si shpenzime dhe për pjesën tjetër do të taten 15 % duke shtuar shpenzimet e tyre vjetore me 525,000 lekë.

- Për të vetëpunësuarit që deklarojnë të ardhura afërsisht 10 milion lekë në vit, sipas draftit do tu njihen 30% e të ardhurave si shpenzime dhe për pjesën tjetër do të tatohen 15 % duke shtuar shpenzimet e tyre vjetore me 1,050,000 lekë.

Pra, për cdo 1 lek rritje të të ardhurave, do të rriten shpenzimet afërsisht me 10%.



Lidhur me normën e tatimit në Shqipëri krahasuar me vendet e rajonit vihet re se:


Maqedonia - Vendi me koston më të ulët të taksave në Ballkan për vitin 2018 është Maqedonia. Në një normë takse të sheshtë 10%, Maqedonia prej vitesh ruan nivelet më të ulëta të tatimit mbi të ardhurat personale dhe tatimit mbi fitimin në rajon.

Kosova - Një vend që përcjell freski në politikën e vet fiskale dhe ruan norma të ulëta tatimore të taksës së sheshtë prej 10%.

Serbia - Një individ që fiton rezidencën në Serbi tatohet me 20% të vlerës së fituar për të ardhurat bruto.

Bosnjë – Hercegovina - Edhe pse me norma të ulëta të tatimit mbi fitimin dhe tatimin mbi të ardhurat personale prej 10% ka një barrë tatimore gjithsej më të lartën në vendet e Ballkanit që nuk janë pjesë e BE-së.

Mali i Zi - Mali i Zi krenohet me taksën më të ulët të tatimit mbi të ardhurat personale dhe normat e tatimit mbi fitimin korporativ në Evropë, të dyja të lidhura në një nivel takse të sheshtë prej 9%.



Sa më sipër argumentuar, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri, hallkë kyçe në njohjen dhe implementimin e të drejtave për biznesin dhe tregun e lire, shpresojmë që sugjerimet e sipërpërmendura të vijnë sado pak në ndihmë në përgatitjen e draftit final për miratim të këtij të fundit si akt ligjor rregullator.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin mbetemi në pritje të një reflektimi sa më pozitiv në dobi të biznesit në vend.